

RAPORT

Mbi takimet e organizuara nga Bashkia Shkodër për të diskutuar draf ligjin “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”

Përgatiti:
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Shkodër, Tetor 2015

1 Tabela e Përmbajtjes

1	Tabela e Përmbajtjes.....	2
2	Hyrje dhe prezantim i iniciativës.....	3
3	Përmbledhje e diskutimeve.....	4
3.1	Takimi i parë: Kompetencat e reja në çështje të bujqësisë, mjedisit dhe shërbimit zjarrëfikës.....	4
3.2	Takimi i dytë: Arsimi, kultura, sportet dhe çështjet sociale.....	7
3.3	Takimi i tretë: Funksionet kryesore vendore	9
3.4	Takimi i katërt: Roli i Këshillit Bashkiak dhe vendimmarrja lokale	10
3.5	Takimi i pestë: Transparenca dhe përfshirja qytetare në vendimmarrjen lokale 15	
4	Koment për përmirësimin e draft Ligjit	16
5	Shtojca	19

2 Hyrje dhe prezantim i iniciativës

Qeveria e Shqipërisë e mbështetur edhe nga një sërë donatorësh ndërmori gjatë vitit 2014 reformën administrative dhe territoriale, e cila u konkretizua me miratimin e Ligjit 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”. Kjo reformë pasohet nga ajo e decentralizimit të qeverisjes, e cila nis me miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, në Korrik 2015.

Në këto kushte bëhet i domosdoshëm hartimi i një sërë ligjesh të reja të cilat të mundësojnë funksionimin dhe operacionalizimin e qeverisjes vendore në Shqipëri, duke filluar me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, Ligjin e Financave Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, etj., si dhe një numër ligjesh sektoriale që do duhet të rishikohen.

Draft Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore është hartuar nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe me asistencë teknike ndërkombëtare. Drafti është në fazë diskutimi me grupe të ndryshme të interesit dhe aktorë të përfshirë në proces, mes të cilave edhe organet e reja të qeverisjes vendore, të zgjedhura gjatë Qershorit 2015.

Për të përfaqësuar sa me mirë komunitetin të cilit i shërben dhe njëkohësisht për të legjitimuar qëndrimin e saj në raport me ligjin, Bashkia Shkodër organizoi një numër takimesh tematike me grupe të ndryshme të interesit në komunitet. Diskutime mbi aspekte të ndryshme të Ligjit u organizuan në secilin prej këtyre takimeve dhe në përfundim të tyre, minutat e takimeve dhe konkluzionet janë përmbledhur në këtë dokument në mënyrë që t’i prezantohen Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe Komisioneve Parlamentare.

Diskutimet u zhvilluan në pesë grupe të organizuara sipas tematikave të mëshposhtme:

- (i) **shërbimet kryesore vendore** (me përfaqësues nga ndërmarrjet e varësisë: pastrimi dhe gjelbërimi; ujësjellësi; sportet; kultura; etj.; administratorët e njësive vendore; etj.)
- (ii) **arsimi dhe çështjet sociale** (me përfaqësues nga Drejtoria Arsimore; qendrat sociale; specialistë të bashkisë për çështjet e arsimit dhe çështjet sociale; përfaqësues të Qarkut, etj.)
- (iii) **kompetencat e reja në çështje të bujqësisë; mjedisit dhe shërbimit zjarrfikës** etj. (me përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë; Agjencitë Rajonale të Mjedisit; Bordi i Kullimit; Shërbimi Zjarrfikës; përfaqësues të Qarkut dhe Prefekturës, etj.)

- (iv) **transparenca dhe përfshirja qytetare në vendim-marrjen lokale** (me organizatat e shoqërisë civile; grupe interesi qytetar; administratorët e njësive vendore; etj.)
- (v) **roli i këshillit lokal dhe vendimarrja lokale** (me këshilltarët vendorë, prefekturën, qarkun, etj.)

Takimet u organizuan nga Bashkia Shkodër me ndihmën e Co-PLAN dhe u mbështetën nga Programi Zvicerian për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal (dldp), gjatë datave 7 dhe 8 Tetor 2015, sipas skedulit të mëposhtëm:

Nr.	Fokusi i diskutimit	Data	Ora
1	Kompetencat e reja në çështje të bujqësisë, mjedisit dhe shërbimit zjarrëfikës	7.10.2015	10.00-12.30
2	Arsimi, kultura, sportet dhe çështjet sociale	7.10.2015	13.00-15.30
3	Shërbimet kryesore vendore	7.10.2015	17.00-19.30
4	Roli i këshillit lokal dhe vendimarrja lokale	8.10.2015	10.00-12.30
5	Transparenca dhe përfshirja qytetare në vendimarrjen lokale	8.10.2015	13.00-15.30

Takimet u karakterizuan nga një frymë shumë e mirë komunikimi dhe bashkëpunimi mes të gjithë aktorëve dhe pjesëmarrësve. Në to morën pjesë rreth 100 përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, përfaqësues të Këshillit të Qarkut dhe përfaqësuesit e Këshillit Vendor të Shkodrës.

3 Përmbledhje e diskutimeve

Më poshtë kemi përgatitur një përmbledhje të pikave kryesore të diskutuara dhe shqetësimeve të ngritura, të organizuara sipas tematikave të takimeve.

3.1 Takimi i parë: Kompetencat e reja në çështje të bujqësisë, mjedisit dhe shërbimit zjarrëfikës

Pjesëmarrës: Përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë; Agjencitë Rajonale të Mjedisit; Bordi i Kullimit; Shërbimi Zjarrfikës; Përfaqësues të Qarkut, Prefekturës; specialistë të Bashkisë për çështjet në fjalë, etj.

- a. Funkcionet në fushën e **mbrojtjes së mjedisit** – mbrojtja e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja; mbrojtja nga ndotja akustike; etj. (neni 26)
Si do të menaxhohet mbrojtja mjedisore? A ka mundësi NJQV-ja të garantojë ofrimin e tyre? Përcaktimi i standardeve të shërbimit dhe financimi i tyre?

Disa nga problemet më të mëdha në lidhje me mbrojtjen e cilësisë së ajrit në Bashkinë e Shkodrës janë: (i) ndotja e madhe nga makinat; (ii) pastrimi i qytetit me fshesa; (iii) ndërtimi dhe procedurat përkatëse.

Mënyra për të kontrolluar cilësinë e ajrit lidhen me ndërmarrjen e një sërë masash siç mund të jenë: (i) pastrimi i qytetit me makina; (ii) kufizimi i qarkullimit të makinave në fundjavë; etj.

Në rastin e mbrojtjes së mjedisit: Agjencia Rajonale e Mjedisit – rol monitorues. Gjithashtu, jep dhe lejet mjedisore. Inspektoriati i Mjedisit – rol zbatues. Bën inspektimin në territor të zbatimit të lejeve mjedisore.

Në rast se mbrojtja e mjedisit kalon si funksion i veti i Bashkisë, atëherë si do të rregullohen raportet me insitucionet e tjera të lartpërmendura?

Referuar ligjit për Lejet Mjedisore, riorganizimi i ri i Bashkisë sjell lehtësi në komunikim mes niveleve të qeverisjes dhe institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.

- b. Funksionet në **fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave** – infrastruktura e ujitjes dhe kullimit dhe menaxhimi i tyre; kadastra e tokave bujqësore; skemat e granteve për zhvillimin rural; administrimin dhe menaxhimin e plotë të pyjeve dhe kullotave; etj. (neni 27)
Si dhe kur do të ndodhë kalimi i funksionit, dispozitat tranzitore...
Strukturat e menaxhimit dhe organizimi/riorganizimi i tyre; Roli i qarkut dhe drejtorive rajonale, etj.

Në fushën e bujqësisë kërohet që të ketë specifika në lidhje me organizimin e tregjeve për produktet bujqësore, të krijohet një fond garancie për prodhimin dhe tregëtimin e produkteve bujqësore.

Një nga problemet tepër të mëdha në lidhje me menaxhimin e kanaleve të kullimit dhe ujitjes ka të bëjë me përdorimin e tyre si kanale për ujërat e zeza, duke shaktuar kështu jo vetëm mosfunksionimin e tyre sipas qëllimit, por edhe probleme të mëdha mjedisore. Kjo ndodh përgjithësisht në zonat rurale dhe periurbane ku kanalizimet janë pothuajse jo-eksistuese.

Në rastin e kaneleve të kullimit, investimi planifikohet dhe realizohet nga qeveria qendrore nëpërmjet ministrisë së linjës. Mirëmbajtja e tyre behet nga Bordi i Kullimit në nivel qarku. Kur ky funksion të decentralizohet kush do të mbulojë pjesën e investimve? Transferimi i këtij funksioni a do të shoqërohet me planifikimin financiar përkatës?

Kanalet e ujitjes primare do të mbeten në menaxhim qendror përse i përket investimeve. Ndërkohë ato sekondare dhe terciare do të kalojnë në varësi të Bashkisë. Deri më sot, për rehabilitimin e tyre nuk janë bërë investime. Në këtë kontekst, a do ti akordohen bashkisë fondet e nevojshme për tu investuar në rehabilitimin e tyre, po për mirmbajtjen?

Një tjetër shqetësim i ngritur nga pjesëmarrësit ishte si do të organizohet menaxhimi i kanaleve të cilat kalojnë në më shumë se një NJQV apo dhe më shumë se një bashki.

Cfarë ndodh sot në lidhje me kadastrën bujqësore?

Kadastra parashikohet të kalojë si funksion i veti i bashkisë. Për rëndësinë e madhe të saj pjesëmarrësit evidentojnë se kemi dy organe që aktualisht disponojnë të dhëna kadastrale:

- i. qarku: ka informacionin e nevojshëm të klasifikuar sipas: (i) zërave kadastral; (ii) akteve të pronësisë; (iii) shpërndarjes sipas ligjit 7501; (iv) listave të ish-pronarëve etj;
- ii. ZRPP: disponon pronat e rregjistruara dhe të dixhitalizuara

Aktualisht këto baza të dhënash nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe gjithshka mbetet në dorë të bashkëpunimit mes institucioneve, i cili në pjesën më të madhe ka qenë në nivele minimale.

Propozohet: nisur nga përcaktimet e draft ligjit për *“ngritjen dhe manaxhimin e kadastrës bujqësore” bashkisë i duhet sanksionuar shprehimisht në ligj garantimi I administrimit dhe bashkimit të dy regjistrave të institucioneve të përmendura më sipër*. Pra do duhet të bëhet harmonizimi i regjistrat kadastral në nivel qarku me atë dixhital që zotëron ZRPP-ja. Gjithashtu, funksioni i ri që transferohet duhet të përmbajë dhe faturën financiare për ta realizuar atë.

- c. Për **shërbimin e zjarrfikëseve** i cili sipas nenit 29, pika 1 kalon në varësi të bashkisë: ekspertët përkatës e shohin të vështirë kalimin e këtij funksioni në varësi të bashkisë në kushtet aktuale (nuk ka mjete fizike, makina dhe burime njerëzore të mjaftueshme). Nevojiten investime të qenësishme në këtë fushë si dhe të sanksionohet deri diku bashkërendimi apo ndihma në raste emergjencash midis zjarrfikëseve të bashkive fqinje.

Në fund të diskutimit gjatë takimit të zhvilluar për të diskutuar kompetencat e reja vendore në çështje të bujqësisë, zhvillimit rural, mbrojtjes së mjedisit dhe shërbimit zjarrfikës, rezultuan këto sugjerime kryesore:

- *Parashikimi i dispozitave tranzitore ligjore që do të rregullojnë tranzicionin e kompetencave nga njësitë qendrore në ato lokale;*
- *Kompetencat e reja që u jepen Bashkive duhet të bërë-përcaktohen duke marrë parasysh që mund të ketë më shumë se një institucion që përgjigjet për të (rasti ZRPP dhe qarku, Bordi i kullimit dhe autoriteti mjedisor);*
- *Vlerësimi në terma financiarë konkretë dhe planifikim financiar i mirëfilltë për ofrimin e këtyre shërbimeve duke ndarë (i) investime dhe (ii) mirëmbajtje;*
- *Ndërtimi i një timeline kur do të ndodhë çfarë: p.sh. faza 1 transferimi i funksionit A, faza 2 riorganizimi i burimeve njerësore në territor, faza 3 buxhetimi i funksionit dhe transferimi i fondeve etj. Ky fazim mund të ishte dhënë që në Strategjinë e Decentralizimit, por në kushtet kur aty mungon dhe ligji nuk e plotëson, mendohet se është i nevojshëm.;*

- *Meqënëse autoritetet vendore do të jenë subjekt monitorimi dhe vlerësimi nga ana e qeverisë nevojitet përcaktimi i standardeve minimale (kombëtare);*
- *Për funksionet të cilat shtrihen dhe implikojnë më shumë se një bashki duhet të specifikohet qartë sesi do të koordinohen ato nën optikën e ofrimit të shërbimit në nivel vendor.*

3.2 Takimi i dytë: Arsimi, kultura, sportet dhe çështjet sociale

Pjesëmarrës: Përfaqësues nga Drejtoria Arsimore; Qendrat sociale; Administratorët e njësisive vendore; Përfaqësues të Qarkut, Përfaqësuesi i Klubit Vllaznia; Prefekturës; specialistë të Bashkisë për çështjet e arsimit dhe çështjet sociale , etj.

Shërbimet sociale

Neni 24, pika 4 togfjalëshi hyrës “*në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqënien sociale...*”. Në kuadrin e projekt ligjit po synohet decentralizimi i funksioneve dhe kalimi i funksioneve në varësi të bashkisë, ndaj kjo rezulton si një mos përputhje konceptuale (duket sikur *de facto* do të vijojë të jetë një funksion i përbashkët). Nga një anë suprimohen funksionet e përbashkëta dhe në këtë nen vendoset që ushtrimi i funksionit në fushën e shërbimeve sociale të realizohet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse.

Burime financiare aktuale a janë të mjaftueshme për ta ofruar këtë shërbim sipas një standardi të caktuar?

Ekspertët e fushës ngrenë dhe një problematikë të lidhur me fondin e shërbimeve sociale pasi hasen papajtueshmëri me ligjin e prokurimeve publike.

Propozohet që fondi për zhvillimin rajonal dhe fondi social që deri më tani është vënë në dispozicion nga ministria përkatëse të bashkohen dhe të ndahen si një fond i kushtëzuar (me formulë të përcaktuar) në kuadrin e ofrimit të shërbimeve sociale për të garantuar një zhvillim territorial të balancuar.

Kultura

Neni 25 citon “*zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal...*” Pjesëmarrësit përfaqësues të Muzeut Shkodër vlerësojnë se përcaktimi në ligj si “lokal” diskriminon dhe provincializon trashëgiminë kulturore kur kjo përfaqëson një pasuri kombëtare.

Në këtë kontekst si parashikohet të ndahet kombëtarja nga lokalja? P.sh.: Muzeu i Shkodrës do të jetë totalisht lokal apo do të ketë varësi të tjera?

Aktualisht Muzeu Shkodër operon në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore të vitit 2003, Ligjin për Muzeumet i vitit 2005 dhe Ligjin Organik të Qeverisjes Vendore. Pjesëmarrësit përfaqësues të Muzeut të Shkodrës sugjerojnë shkrirjen në një

ligj të vetëm gjithpërfshirës të legjislacionit ekzistues për të evituar mospëruthje dhe konflikte të mundshme. Gjithashtu, të përfshihet në nenin 25, pika 1 “*në përputhje me politikat kombëtare për kulturën*”. Nëse do të lihej ashtu si është propozuar në projekt ligj do të kishim një varësi të dyfishtë përsa i përket trashëgimisë kulturore (nën varësinë e ministrisë) dhe administrimit insitucional vendor (bashkisë).

Sporti

Neni 25 pika 4 citon: “*organizimi i aktiviteteve sportive rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve*”

Kërkohej që në ligjin e ri të përfshihet një pikë ku t’i njihet e drejta bashkisë të nxisë përfshirjen e sponsorve në jetën sportive duke krijuar disa facilitete si p.sh.: në nivel taksash lokale.

Si do të jetë ekuilibri midis shoqatave, federatës dhe klubit sportiv? Situata financiare paraqitet problematike.

Arsimi

Vlerësohet se shërbimi arsimor deri para-universitar mund të ofrohet më mirë nga njësitë vendore të qeverisjes duke qenë më pranë bashkësisë.

Neni 23, pika 13 i njeh bashkisë kompetencën për “*ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar*”. Sipas kësaj pike, në ligjin e propozuar, bashkia bëhet përgjegjëse për ndërtimin e shkollave, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e tyre por nuk përfshihet në administrimin e tyre. Praktikisht, ajo nuk ka të drejtë të zgjedhë stafin për funksionin e mirëmbajtjes. Staf i mësimeve mbetet në varësi të ministrisë së linjës.

Përfaqësuesit kërkojnë që në ligjin e ri të parashikohet një përfshirje më aktive e bashkisë në çështjet administrative të shkollës, p.sh.: politika për rregjistrimin e nxënësve.

Kërkohej që bashkia të ketë autoritet në planifikimin e shërbimit arsimor për territorin përkatës nga autoriteti vendor. Pra, përcatimi i numrit të shkollave në territor, vendimi për ndërtimin e shkollave të reja përkundrejt vendosjes së shërbimit të transportit për nxënësit në zona të thella, etj. mund të jenë në përgjegjësinë dhe autoritetin e bashkisë. Argumentohet se në zona të caktuara, ku ka vetëm 5-6 nxënës të moshave të ndryshme dhe arsimohen nga një mësues me njohuri të përgjithshme, nuk rezulton efiçente si në terma financiarë ashtu dhe të njohurive për nxënësit të ndërtohet një shkollë e re. Kështu, do të ishte më produktive që të vendosej shërbim transporti për këta nxënës për në shkollën më të afërt. Kjo do të ndodhte vetëm nëse bashkia do të kishte autoritet për të planifikuar shërbimin arsimor në territorin e saj.

Në fund të diskutimit gjatë takimit të dytë, të fokusuar në çështjet për arsimin, kulturën, sportet dhe çështjet sociale, rezultuan këto sugjerime kryesore:

- *Kërkohet realizimi i një analize kosto – çmim minimal për ofrimin e shërbimeve dhe përkthimin në standard;*
- *Përcaktimi i standardeve minimale (kombëtare) që do të përbëjnë bazën e vlerësimit të autoriteteve lokale nga ato qendrore;*
- *Nevojitet planifikimin financiar për të ofruar shërbimet, për t'i ofruar ato në përmbushje të standardeve minimale duke mbuluar kostot e realizimit të tyre;*
- *Shtimin e domosdoshëm në ligj i autoritetit për “planifikim” të shërbimit arsimor për territorin përkatës;*
- *Kur do të jenë të disponueshëm standardet? Ministrinë e linjës mund të mbikqyrin dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve pasi të kenë hartuar standardet përkatëse të ofrimit të shërbimeve.;*
- *Qartësimin mbi çfarë është kombëtare dhe çfarë është lokale në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore;*
- *Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe fondet e Ministrive të Linjës për shërbimet sociale të kalojnë në NJQV si transfertë e kushtëzuar më një formulë.*

3.3 Takimi i tretë: Funkzionet kryesore vendore

Pjesëmarrës: Përfaqësues nga ndërmarrjet e varësisë së bashkisë; pastrimi dhe gjelbërimi; ujësjellësi; sportet; kultura; etj.; Administratorët e njësisve vendore; Përfaqësues të Qarkut, Prefekturës, Drejtorisë Rajonale të Thesarit; dhe sektorë e departamente të financave vendore, etj.

Juridikisht suprimohen funksionet e përbashkëta, por praktikisht ka nene të ligjit që parashikojnë “sipas ligjit sektorial”, “së bashku me ministrinë” – *de facto* nuk përcaktohet qartë autonomia vendore. Në ushtrimin e funksioneve që duhet të jenë të sajat, bashkia mund të gjendet në situata administrimi të dyfishtë.

Neni 37 trajton të ardhurat nga burimet kombëtare. Cili do të jetë niveli i tyre apo pjesa që do t'i transferohet bashkisë; si % e kujt, si do të realizohet shpërndarja; dhe si do të aplikohet shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar?

Neni 37, pika a sugjerohet që në vend të fjalës “një pjesë” të vendoset konkretisht përqindja dhe të syhonet rregullimi i pabarazive nëpërmjet rishpërndarjes së të ardhurave.

Neni 37, pika a sugjerohet që për arsye operative dhe objektive transfertat për taksa dhe tatime të ndara të kalojnë me frekuencë mujore dhe jo tremujore. Pagesat kryehen në bazë mujore ndaj do të ishtë me përshtatshme për të evituar ngërçe financiare.

Sugjerohet gjithashtu të realizohet një konsultim paraprak me bashkinë kur të përcaktohet transfertat e pakushtëzuar.

Ka paqartësi si do të konsolidohet sistemi i ujësjellës kanalizimeve brenda qarkut dhe kur do të hyjë në fuqi administrimi i tyre nga bashkia.

Propozohet që Fondi i Zhvillimit të Rajoneve të kalojë pjeësërisht si fond për investime.

Neni 22, pika 3, në pjesën e dytë të fjalisë “qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare” propozohet të shkruhet “do të japë mbështetjen e nevojshme financiare”. Çfarë ndodh në rast se qeveria nuk i jep këto fonde?

Në ushtrimin e funksioneve të veta në nenin 35, pika 3, kërkohet që krahas kompetencës për “përrjashtim nga pagimi i taksës...” të shtohet dhe kompetenca për “aplikim të diferencuar të taksës”.

Neni 29, pika 3 kërkohet të përkufizohet më mirë funksioni i ndërmjetësuesit komunitar.

Në fund të diskutimit gjatë takimit të tretë, të fokusuar në funksionet kryesore vendore, rezultuan këto sugjerime kryesore:

- *Nevojë për qartësim të kompetencave në ushtrimin e funksioneve;*
- *Nevojë për qartësim të formulës dhe mënyrave të shpërndarjes së burimeve financiare për ofrimin e shërbimeve të reja që kalojnë pranë bashkive;*
- *Cili autoritet do të përcaktojë standardet minimale?;*
- *Krahas përrjashtimit nga taksat duhet shtuar dhe kompetenca për aplikim të diferencuar të taksave;*
- *Në nenin 23, pika 14 kërkohet të shtohet fjala “zhvillim i territorit”; kërkohet gjithashtu një shprehje më e mirë dhe koordinuar dhe me ligjin sektorial;*
- *Në ushtrimin e funksioneve të veta në nenin 35, pika 3, kërkohet që krahas kompetencës për “përrjashtim nga pagimi i taksës...” të shtohet dhe kompetenca për “aplikim të diferencuar të taksës”;*
- *Neni 22, pika 3, në pjesën e dytë të fjalisë “qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare” propozohet të shkruhet “do të japë mbështetjen e nevojshme financiare”.*

3.4 Takimi i katërt: Roli i Këshillit Bashkiak dhe vendimmarrja lokale

Pjesëmarrës: Këshilltarët bashkiakë, përfaqësues të koalicioneve të majtë dhe të djathtë politikë; përfaqësues të Prefektit; përfaqësues të Këshillit të Qarkut; Kryetari i Këshillit Bashkiak, Kryetarja e Bashkisë, etj..

Mbi rolin dhe funksionet e Këshillit të Qarkut u shpreh Kryetarja e Këshillit të Qarkut (bashkëngjitur, në Shtojcën 3 diskutimi përkatës).

Neni 31, pika 1, Funksionet e Qarkut, citon: “Funksionet e veta të qarkut janë ndërtimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i veti i dhënë me ligj”. Sugjerohet se me ligj Këshillit të Qarkut duhet t’i kalohen kompetenca si:

- bashkëpunimi me universitetet apo institucione të specializuara vendase apo të huaja, për kërkime dhe inovacione, për transferimin e teknologjive bashkëkohore si dhe aplikimin praktikave të përparuara në territor;
- të bashkëpunojë me ministrinë e linjës dhe zyrat rajonale përkatëse si dhe institucione të tjera vendore apo dhe jo publike duke koordinuar ato nëpërmjet bordit rajonal të punësimit, aplikimin e strategjisë rajonale të punësimit;
- bashkitë krijojnë dhe administrojnë shërbime për territorin e tyre, qarku mundëson shpërndarjen e shërbimeve në ato njësi ku ato mungojnë sipas nevojave të vlerësuara;
- krijojnë baze të dhënash statistikore dhe Hartën e Vlerësimit të Nevojave mbi gjendjen social ekonomike të qarkut, në baze të cilave përcaktohen prioritetet dhe rrugët për realizimin e tyre sipas një plani komunitar rajonal;
- mbledh problemet dhe krijojnë tematikat sociale sidomos për fenomenet dhe nevojat aktuale të zhvillimit;
- fokuson ndërhyrjet sociale nëpërmjet fondit social rajonal duke ju përgjigjur nevojave të ndërhyrjes në kohë optimale;
- në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e linjës, të orientojnë zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional sipas nevojave të tregut rajonal të punës;
- të angazhohet vetë, apo në bashkëpunim me njësi të tjera vendore dhe Organizata jofitimprurëse, sikurse dhe të krijojë agjenci e njësi të tjera vartësie, për tu përfshirë në programet e bashkimit evropian në nivel vendor duke mundësuar që nëpërmjet projekteve të veçanta të realizojë aktivitete në zbatim të politikave të zhvillimit të territorit e të vetë qarkut.

Për sa i përket detajeve teknike të projekt ligjit propozohen rregullime teknike që duhet të kihet parasysh edhe pse në takimin konsultativ me kryetaret e njësive vendore dhe ekspertet ligjore të njësive vendore të qarqeve Shkodër, Lezhë, Kukës dhe Dibër, të datës 29 shtator 2015 janë cituar, konkretisht:

- Neni 109, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë citon: *“Organet e njësive të qeverisjes vendore kanë të drejtë të formojnë bashkime dhe institucione të përbashkëta me njëri-tjetrin për përfaqësimin e interesave të tyre, të bashkëpunojnë me njësitë vendore të vendeve të tjera, si dhe të përfaqësohen në organizatat ndërkombëtare të pushteteve vendore.”* Në nenin 14, pika 4 e projekt ligjit, mbi bashkëpunimi ndërvendor citohet: *“Njësitë e qeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndër vendor me njësi të qeverisjes vendore të shteteve të huaja. Përpara lidhjes së këtyre marrëveshjeve, njësitë e qeverisjes vendore marrin pëlqimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore dhe me pas autorizimin me shkrim të ministrit të punëve të jashtme.”*
Një të drejtë që ta jep kushtetuta nuk mund ta kufizojë asnjë institucion tjetër.
- Neni 22, pika 3 citon: *“Në rastet kur njësitë e qeverisjes vendore nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare.”* Po t’i referohemi standardit të performancës së personelit është rekomanduar që fondi i pakushtëzuar nga buxheti i shtetit, në kuptim të nenit 38 të projekt ligjit, të përdoret për fond pagash vetëm 50%. Në ligjin për

buxhetin e shtetit 2015 ky fond pa asnjë argumentim moral apo ligjor është limituar në 15%. Cili është standardi që do të mbështesë qeveria?

- Në nenin 5 të projekt ligjit, pika 5 citon: “Qarku përfaqëson një unitet administrativo – territorial të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët...”, ndërsa në nenin 110, pika 1, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thuhet: “Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e sociale dhe të interesave të përbashkët.” Pika 2, thotë: “Qarku është njësia ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore.” Ndërsa në nenin 38 të projekt ligjit pika 3, thuhet: “Qarku mund të financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive për kryerjen e funksioneve të veta.”

Kuotat e anëtarësisë së një shoqate e jo me të një qarku, i vendos asamblea e shoqatës e jo në mënyrë fakultative anëtari. Këshillin e qarkut e përbëjnë të zgjedhurit vendorë, ndaj është ky këshill që vendos mbi vlerën e detyrimit që kanë bashkitë ndaj qarkut, që sipas mendimit tonë duhet të variojë nga 2 deri në 3 % të të ardhurave të tyre.

- Në nenin 30, për funksionet e deleguara, thuhet: Pika 3 “Institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë Bashkinë ose qarkun të kryejnë funksione të caktuara të institucioneve qendrore, duke përcaktuar procedurat e kryerjes dhe të kontrollit për zbatimin e tyre.” Pika 4. “Institucionet qendrore mund të autorizojnë Bashkinë dhe/ose qarkun të ushtrijnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar.” Në këtë rast terminologjia teknike e përdorur i referohet Bashkisë ose qarkut, dhe nënkupton një hapësirë territoriale dhe jo një njësi apo organ administrativ.

Duhet thënë se kompetencat i kalojnë njësisë të qeverisjes vendore ose këshillit të bashkisë, kryetarit të bashkisë dhe këshillit të qarkut.

- Neni 51, Të drejtat e këshilltarit, thotë: Pika 1. “Këshilltari nuk përgjigjet për mendime të shprehura, lidhur me çështje zyrtare gjatë ushtrimit të detyrës.” Pika 2. “Këshilltari kryen funksionin pa shpërblim. Ai ka të drejtë të rimbursohet për shpenzime udhëtimi për të marrë pjesë në mbledhjen e këshillit sipas legjislacionit në fuqi.”

Çdo lloj pune në konceptin e përgjithshëm ka një pagesë, aq më tepër në rastin e këshilltarit si person i zgjedhur në një këshill lokal, ku së paku do të duhet të marrë njohuri për legjislacionin lokal dhe njëkohësisht të punojnë për të përmbushur përgjegjësitë e tij në aprovimin e vendimeve akteve normative, që nxjerrin këshillat e njësisë të qeverisjes vendore. Po në rastin e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë, apo drejtimin e komisioneve përkatëse, sa interes do kenë këshilltarët. Si do jete pjesëmarrja e tyre në punët e komisioneve? Po në rastin e mbledhjeve të jashtëzakonshme a do arrihen kuorumet vendimmarrëse? Pasi siç vetëkuptohet ato do i japin përparësi punës së tyre profesionale nga e cila sigurojnë të ardhurat. Ky lloj trajtimi nxit indiferencë dhe nuk e bën aktiv sa duhet rolin e këshilltarit në parlamentin e qytetit apo te qarkut. Stimulimi i tyre do t'i bënte këta të fundit të ndjeheshin më të përgjegjshëm në jetën social ekonomike dhe të merrnin iniciativa lokale dhe rajonale, të dëgjonin zërin e komunitetit ku banojnë dhe të grupeve te interesit, duke u bërë pjesë aktive e procesit të vendimmarrjes që gjithmonë kërkon një përfshirje sa më të gjerë.

Për figurën e kryetarit të bashkisë dhe të këshilltarëve bashkiakë kërkohet që të vendosen përcaktime për cilësitë individuale për të qenë një kandidat i tillë (përcaktimi i një CV-je)

Sekretari i Këshillit sugjeron disa ndryshime në projekt ligj si më poshtë:

Neni 6 (Nënndarjet e bashkisë)

1. *Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj.*
2. *Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe fshatrave, pjesë e çdo njësie administrative, përcaktohen me ligj. Shpallja e qyteteve të reja bëhet me ligj.*
3. ***Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje. Një lagje, si rregull, mund të krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë. Ndarja e qyteteve në lagje dhe shtrirja e tyre territoriale miratohet me vendim të këshillit bashkiak.***

Neni 6, pika 3 parashikon që vetëm qyteti mund të ndahet në lagje, ndërkohë që në nenin 70 ,pika 1 parashikohet: “...Në rastet kur **fshati** përbëhet nga disa lagje...” Pra pika 3 e nenit 6 nuk parashikon që fshati të mund të ndahet në lagje por vetëm qyteti. Për më tepër për t’u quajtur lagje duhet të ketë mbi 20.000 banorë.

Neni 22 (Parimet për ushtrimin e funksioneve)

4. *Njësitë e qeverisjes vendore administrojnë ushtrimin e funksioneve të deleguara sipas rregullave të përcaktuara nga qeverisja qendrore. Ato mund të rregullojnë ushtrimin e këtyre funksioneve vetëm nëse dhe për aq sa janë autorizuar shprehimisht në ligjin mbi të cilin është deleguar funksioni.*

Neni 54

n) *Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim te bashkia;*

Përkufizimi i pikës 4 të nenit 22 është në kundërshtim me kompetencën e këshillit bashkiak parashikuar në nenin 54 shkronja “n”. Pra, *rregullat për realizimin e funksioneve të deleguara janë kompetencë e këshillit*, ndërkohë që në nenin 22 pika 4 parashikohet *...sipas rregullave të përcaktuara nga qeverisja qendrore.*

Pyetje: rregullat për funksionet e deleguara i vendos qeveria apo bashkia? Po e drejta për miratimin e statutit që sanksionohej në ligjin e vjetër?

Neni 47 (Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit)

3. *Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrrri e vjehrra me nusen dhe dhëndrin.*

Sugjerohet që pika e 3 e nenit 47 nuk duhet të jetë. Një kushtëzim i tillë nuk parashikohet as për zgjedhjet parlamentare. Edhe sikur të jetë si pikë, nuk parashikohet se si mund të zgjidhet papajtueshmeria nëse jemi në një rast të tillë.

Neni 55 (Votimi)

Vlerësohet se kompetenca e parashikuar në nenin 54 shkronja “f” nuk duhet të kërkojë miratimin me shumicë të cilesuar 3/5 por të miratohet me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit, pra të përfshihet në pikën 3 të nenit 55, shumica që kërkohet edhe për miratimin e buxhetit. Një shumicë e tillë aplikohet edhe në Kuvend për këtë lloj vendimarrjeje.

Pika 6 e nenit 55 sugjerohet të riformulohet:

“Aktet e këshillit hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë”.

Neni 64 (Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë)

Shkronja “f” vlerësohet të rishihet sepse krijon konflikt ligjor me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për emërimin dhe shkarkimin e organeve drejtuese të shoqërive tregtare...

Shkronja “i” në rastin e kthimit të vendimit nga kryetari i bashkisë, duhet të saktësohet me çfarë shumice votash, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim (e thjeshtë; e kualifikuar?).

Neni 66 (Detyrat e administratës së njësisë administrative)

Pika 1 shkronja “g”. Mendohet se është në kundërshtim me shkronjen “m” të nenit 54. *Kompetencën për të dhënë tituj nderi dhe stimuj, e ka këshilli bashkiak dhe jo kryetari i bashkisë.*

Neni 70 (Struktura komunitare në fshat)

Sugjerohet të rishihet mënyra e zgjedhjes së kryesisë dhe kryetarit të fshatit. Mënyra e parashikuar me votim nga të gjithë banorët e fshatit, vlerësohet se nuk ka funksionuar ndër vite, dhe siç është parashikuar përsëri, është një proces që kërkon një angazhim shumë të madh si procedural ashtu edhe financiar (të ngjashëm me procesin zgjedhor për zgjedhjen e këshillit bashkiak).

Neni 78 (Votimi)

Pika 1, sugjerohet të rishihet sepse duhet të lidhet me nenin 77.

Për pikën 3, sugjerohet të njëjtin përcaktim si tek pika 6 e nenit 55.

Më tej diskutimet u ndalën në aspekte të tjera të ofrimit të shërbimeve vendore dhe diskutantët ngritën shqetësimet dhe bënë sugjerimet si më poshtë:

Në administrimin e shërbimeve publike, vecanërisht për sa i përket shumëllojshmërisë së partneriteteve kërkohet që *të sqarohet nëse Bashkisë i njihet e drejta e dhënies së koncesioneve.*

Duhet me patjetër të bëhet *përcaktimi dhe transparenca në koeficientët që do të përdoren në ndarjen e të ardhurave kombëtare.*

Të rishikohet ligji për taksat vendore dhe të lihet më shumë autonomi në planifikimin e taksave lokale (diskrecion më i madh për bashkinë).

Në ndërtimin e formulës për transfertën e pakushtëzuar, a është studiuar territori dhe nëse jo pse?

Neni 11, pika 2 “*organet e njqy, për fushën e tyre të përgjegjësisë, janë të detyruara të informojnë më shkrim për çdo çështje që ju kërkohet informacion nga organet e qeverisjes vendore në veçanti nga Prefekti i Qarkut*”; dhe pika 3 “*organet e qeverisjes qendrore, në veçanti Prefekti i Qarkut, kurdoherë që kërkohet, informacion nga organet e qeverisjes vendore janë të detyruara të japin informacion, brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi*”

Të përcaktohet në ligj një terminologji koherente, proporcionale, koha dhe format e raportimit.

Neni 13 pika 1 “*me qëllim garantimin e zbatimit të standardeve kombëtare të përcaktuara në legjislacionin përkatës....*” ***Vlerësohet si emergjente përcaktimi i standardeve kombëtare për efekt monitorimi si dhe sugjerohet të përdoren standarde të diferencuara:*** p.sh.: i njeiti standard do të aplikohet si në bashkinë Shkodër dhe në bashkinë Pustec?. ***Gjithashtu, në vendosjen e standardeve duhet bërë transparente metodologjia e llogaritjes së kostove në funksion të vendosjes së tarifave për shërimet.***

Për shërbimet shëndetësore kërkohet që të mirë përcaktohen fondet që do të shkojnë për investime.

3.5 Takimi i pestë: Transparenca dhe përfshirja qytetare në vendimmarrjen lokale

Pjesëmarrës: Organizatat e Shoqërisë Civile; grupe interesi qytetar; Administratorët e njësive vendore; etj.

Rritja e pjesëmarrjes qytetare vlerësohet si një mundësi dhe si një detyrim nga drejtuesit e shoqatat pjesëmarrëse në takim.

Sugjerohet thjeshtim i procedurës së zgjedhjes së kryetarit dhe kryesisë së fshatit pasi eksperiencia ka treguar se formula e propozuar nuk ka funksionuar. Votimi propozohet të quhet i vlefshëm me shumicë të thjeshtë të të pranishmëve në votim.

Diku në ligj të parashikohet që shoqëria civile të jetë prezent në cdo hap që nga planifikimi deri tek ofrimi i shërbimeve.

Sugjerohet të konsiderohet pozicioni i gjuetisë si sport. Nëse bashkia merr nën administrim pyjet, kush merret me dhënien e lejeve për gjueti dhe mbledhjen e të ardhurave nga ky aktivitet?

Të shtohet një pikë në nenin 20 të ligjit ku, organizimet komunitare të kenë mundësi t'i çojnë propozime bashkisë dhe ajo të detyrohet t'i shqyrtojë dhe t'i mbështesë në

përputhje me legjislacionin përkatës (p.sh.: 50 banorë të një lagje organizohen për një qëllim apo shqetësim të cilin mendojnë ta zgjidhin me burimet financiare të veta, vendosja e një lodre për fëmijë në sheshin e pallatit).

Të konsiderohen referendimet lokale për çështje të rëndësishme që i përkasin territorit të bashkisë dhe të pranohen rezultatet që derivojnë prej tyre.

4 Koment për përmirësimin e draft Ligjit

Referuar përmbledhjes së diskutimeve të prezantuar më sipër si dhe shtojcave me shënime të takimeve të organizuara bashkangjitur këtij materiali, më poshtë po listojmë disa prej komenteve dhe rekomandimeve kryesore për çështjet që do duhet të reflektohen e përmirësohen në draftLigjin Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore.

- Neni 2, pika 2, që jep përkufizimin për funksionet e veta të qeverisjes vendore, ka nevojë të kategorizojë qartë funksionet e veta të njësive vendore, duke specifikuar ushtrimin e autoritetit administrativ, të shërbimit, të investimit dhe ate rregullator të njësisë së qeverisjes vendore për ushtrimin e funksionit. Këto katër aspekte në ushtrimin e funksionit dhe përgjegjësia mbi secilin prej tyre, bëjnë të mundur përcaktimin e një funksioni si funksion i vetë i qeverisjes vendore, funksion i përbashkët apo funksion i deleguar. Përcaktimi me ligje apo akte nënligjore sektoriale i funksioneve të veta të njësive të qeverisjes vendore, nuk bën gjë tjetër por e shndërron këtë ligj, nga një ligj kornizë për decentralizimin dhe funksionimin e organizimin e qeverisjes vendore, në një ligj plotësues për ligjet sektoriale. Njëkohësisht riskon parimet kryesore të decentralizimit, të cilat udhëheqin hartimin e këtij ligji.
- Ligji suprimon konceptin e funksioneve të përbashkëta, duke synuar që të shmangë paqartësira dhe konfuzione që kanë ekzistuar në lidhje me ofrimin e shërbimeve të caktuara që i përkisnin grupit të funksioneve të përbashkëta mes nivelit qendror dhe vendor të qeverisjes. Pavarësisht vullnetit për të shmangur këtë konfuzion, theksojmë se nuk është moskategorizimi i funksionit në të përbashkët ose jo që e shkakton atë, por ndarja e qartë e përgjegjësive për administrimin dhe rregullimin e funksionit. Duke qënë se ligji organik për një pjesë të funksioneve e lë këtë në varësi të legjislacionit sektorial, ky risk është eminent.
- Në shumë raste ligji i referohet ofrimit të shërbimeve sipas standardeve minimale kombëtare të përcaktuara nga legjislacioni sektorial. Ky përcaktim është veçanërisht delikat dhe e bën ligjin vulnerabël, sidomos kur diskutohen aspekte të mënyrës së financimit të funksionit dhe autoritetit vendor dhe/apo qendror për të mundësuar financimin.
- Meqënëse autoritetet vendore do të jenë subjekt monitorimi dhe vlerësimi nga ana e qeverisë nevojitet përcaktimi i standardeve minimale (kombëtare); Përcaktimi i standardeve minimale (kombëtare) do të përbëjë bazën e vlerësimit të autoriteteve lokale nga ato qendrore. Kërkohet realizimi i një analize kosto – çmim minimal për ofrimin e shërbimeve dhe përkthimin në standard.

- Kërkohej parashikimi i dispozitave tranzitore ligjore që do të rregullojnë tranzicionin e kompetencave nga njësitë qendrore në ato lokale.
- Ndërtimi i një timeline kur do të ndodhë çfarë: p.sh.: faza 1 - transferimi i funksionit A, faza 2 - riorganizimi i burimeve njerësore në territor, faza 3 buxheti i funksionit dhe transferimi i fondeve etj. Ky fazim mund të ishte dhënë që në Strategjinë e Decentralizimit, por në kushtet kur aty mungon dhe ligji nuk e plotëson, mendohet se është i nevojshëm.
- Kompetencat e reja që u jepen Bashkive duhet të mire-përcaktohen duke marrë parasysh që mund të ketë më shumë se një institucion që përgjigjet për të (rasti ZRPP dhe qarku, Bordi i kullimit dhe autoriteti mjedisor);
- Për funksionet të cilat shtrihen dhe implikojnë më shumë se një bashki duhet të specifikohet qartë sesi do të koordinohen ato nën optikën e ofrimit të shërbimit në nivel vendor.
- Shtimin e domosdoshëm në ligj i autoritetit për “planifikim” të shërbimit arsimor për territorin përkatës.
- Qartësimin mbi çfarë është kombëtare dhe çfarë është lokale në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore.
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe fondet e Ministrive të Linjës për shërbimet sociale të kalojnë në NJQV si transfertë e kushtëzuar më një formulë.
- Nevojë për qartësim të formulës dhe mënyrave të shpërndarjes së burimeve financiare për ofrimin e shërbimeve të reja që kalojnë pranë bashkive.
- Krahas përjashtimit nga taksat duhet shtuar dhe kompetenca për aplikim të diferencuar të taksave.
- Në nenin 23, pika 14 kërkohej të shtohet fjala “zhvillim i territorit”; kërkohej gjithashtu një shprehje më e mirë dhe koordinuar dhe me ligjin sektorial.
- Në ushtrimin e funksioneve të veta në nenin 35, pika 3, kërkohej që krahas kompetencës për “përjashtim nga pagimi i taksës...” të shtohet dhe kompetenca për “aplikim të diferencuar të taksës”.
- Neni 22, pika 3, në pjesën e dytë të fjalisë “qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare” propozohet të shkruhet “do të japë mbështetjen e nevojshme financiare”.
- Në lidhje me funksionet e qarkut sugjerohen një sërë funksionesh të cilat mund të jenë në kompetencën e tij për t’u ofruar, siç parashtrohen më sipër në diskutimin e Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër.
- Në nenin 14, pika 4 e projekt ligjit, mbi bashkëpunimi ndërvendor citohet: “Njësitë e qeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndër vendor me njësi të qeverisjes vendore të shteteve të huaja. Përpara lidhjes së këtyre marrëveshjeve, njësitë e qeverisjes vendore marrin pëlqimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore dhe me pas autorizimin me shkrim të ministrit të punëve të jashtme.” Ndërkohë, neni 109, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë citon: “Organet e njësive të qeverisjes vendore kanë të drejtë të formojnë bashkime dhe institucione të përbashkëta me njëri-tjetrin për përfaqësimin e interesave të tyre, të bashkëpunojnë me njësitë vendore të vendeve të tjera, si dhe të përfaqësohen në organizatat ndërkombëtare të pushteteve vendore.”
Kërkohej që të rishikohet përcaktimi i ligjit pasi është në kundërshtim me një të drejtë të njohur nga Kushtetuta.
- Referuar nenit 38 të projekt ligjit pika 3, ku thuhet: “Qarku mund të financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në

buxhetin vjetor të bashkive për kryerjen e funksioneve të veta.”, theksojme se: Këshillin e qarkut e përbëjnë të zgjedhurit vendorë, ndaj është ky këshill që duhet të vendosë mbi vlerën e detyrimit që kanë bashkitë ndaj qarkut, që duhet të variojë nga 2 deri në 3 % të të ardhurave të tyre.

- Në lidhje me nenin 51, mbi të drejtat e këshilltarit, tërheqim vëmendjen se: Çdo lloj pune në konceptin e përgjithshëm ka një pagesë, aq më tepër në rastin e këshilltarit si person i zgjedhur në një këshill lokal, ku së paku do të duhet të marrë njohuri për legjislacionin lokal dhe njëkohësisht të punojnë për të përmbushur përgjegjësitë e tij në aprovimin e vendimeve akteve normative, që nxjerrin këshillat e njësive të qeverisjes vendore. Po në rastin e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë, apo drejtimin e komisioneve përkatëse, sa interes do kenë këshilltarët. Si do jete pjesëmarrja e tyre në punët e komisioneve? Po në rastin e mbledhjeve të jashtëzakonshme a do arrihen kuorumet vendimmarrëse? Pasi siç vetëkuptohet ato do i japin përparësi punës së tyre profesionale nga e cila sigurojnë të ardhurat. Ky lloj trajtimi nxit indiferencë dhe nuk e bën aktiv sa duhet rolin e këshilltarit në parlamentin e qytetit apo të qarkut. Stimulimi i tyre do t'i bënte këta të fundit të ndjeheshin më të përgjegjshëm në jetën social ekonomike dhe të merrnin iniciativa lokale dhe rajonale, të dëgjonin zërin e komunitetit ku banojnë dhe të grupeve të interesit, duke u bërë pjesë aktive e procesit të vendimmarrjes që gjithmonë kërkon një përfshirje sa më të gjerë.
- Në nenin 70 pika 1 parashikohet *...Në rastet kur fshati përbëhet nga disa lagje...* Ndërkohë, pika 3 e nenit 6 parashikon që vetëm qyteti mund të ndahet në lagje. Pra, pika 3 e nenit 6 nuk parashikon që fshati të mund të ndahet në lagje, por vetëm qyteti. Për më tepër për t'u quajtur lagje duhet të ketë mbi 20.000 banorë. Duhet të ketë një *lapsus* në draft ligj, dhe ky duhet korrigjuar.
- Përkufizimi i pikës 4 të nenit 22 është në kundërshtim me kompetencën e këshillit bashkiak parashikuar në nenin 54 shkronja “n”. Pra, rregullat për realizmin e funksioneve të deleguara janë kompetencë e këshillit, ndërkohë që në nenin 22 pika 4 parashikohet: *“...sipas rregullave të përcaktuara nga qeverisja qendrore”*.
- Sugjerohet që pika e 3 e nenit 47 nuk duhet të jetë. Një kushtëzim i tillë nuk parashikohet as për zgjedhjet parlamentare. Edhe sikur të jetë si pikë, nuk parashikohet se si mund të zgjidhet papajtueshmëria nëse jemi në një rast të tillë.
- Në nenin 64, mbi kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë, shkronja “f” vlerësohet të rishihet sepse krijon konflikt ligjor me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për emërimin dhe shkarkimin e organeve drejtuese të shoqërive tregtare.
- Sugjerohet të rishihet mënyra e zgjedhjes së kryesisë dhe kryetarit të fshatit. Mënyra e parashikuar me votim nga të gjithë banorët e fshatit, vlerësohet se nuk ka funksionuar ndër vite, dhe siç është parashikuar përsëri, është një proces që kërkon një angazhim shumë të madh si procedural ashtu edhe financiar (të ngjashëm me procesin zgjedhor për zgjedhjen e këshillit bashkiak).
- Në administrimin e shërbimeve publike, vecanërisht për sa i përket shumëllojshmërisë së partneriteteve kërkohet që të sqarohet nëse Bashkisë i njihet e drejta e dhënies së koncesioneve.
- Referuar nenit 11, pika 2 *“organet e njq, për fushën e tyre të përgjegjësisë, janë të detyruara të informojnë më shkrim për çdo çështje që ju kërkohet*

informacion nga organet e qeverisjes vendore në veçanti nga Prefekti i Qarkut”; dhe pika 3 “organet e qeverisjes qendrore, në veçanti Prefekti i Qarkut, kurdoherë që kërkohet, informacion nga organet e qeverisjes vendore janë të detyruara të japin informacion, brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi”; sugjerojmë: të përcaktohet në ligj një terminologji koherente, proporcionale, koha dhe format e raportimit.

5 Shtojca

Shtojca 1. Shënime për të lehtësuar diskutimin mbi Ligjin për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore në Bashkinë Shkodër, file poëerpoint

Shtojca 2. Ftesa dhe agjenda e takimeve të organizuara nga Bashkia Shkodër

Shtojca 3. Diskutimi i Kryetares së Këshillit të Qarkut në lidhje me LOFQV-në

Shtojca 4. Diskutimi i përfaqësuesit të Këshillit Bashkiak në lidhje me LOFQV-në

Shtojca 5. Foto nga takimet e organizuara në kuadër të diskutimeve të draft LOFQV-së.